



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 196/1 Prot.

Durrës më, 30/01 /2023

V E N D I M

Nr. 12 Datë 30/01 2023

PËR

"MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR SI DHE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL (2 VJEÇAR), NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE PROFESIONAL SI DHE NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË", PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69 pika 3, si dhe referuar shkresës nr.85/3 datë 20.01.2023 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, shkresës nr.378 datë 23.12.2022 dhe nr. 1952/2 datë 28.12.2022 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës nr.85/1 datë 18.01.2023 të Fakultetit të Studimeve Profesionale, shkresës nr.85/1 datë 13.01.2023 dhe nr.86/1 datë 13.01.2023 të Fakultetit të Edukimit, shkresës nr.85 datë 13.01.2023 dhe nr.86 datë 13.01.2023 të Fakultetit të Biznesit, lidhur me përcaktimin e kriterëve për të tre ciklet e studimit, për vitin akademik 2024 – 2025, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik ,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor si dhe në programet e studimeve me karakter profesional (2 vjeçar), në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Profesional si dhe në ciklin e tretë të studimeve, "Doktoratë", për vitin akademik 2024-2025, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët.
 - Administratori.
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. **Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

